



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

2000

Nr. _____ Prot

0306

Peshkopi, më _____.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për dijeni Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 19

Datë: 28.05.2025

“Për trajtimin me subvencionim të qerasë znj.Manjola Nezir Mera”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr.19 Datë 28/05/2025

“Për trajtimin me bonus qeraje”


Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar, vendimit nr.384 datë 12.06.2019 të Këshillit të Ministrave “për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas cdo program social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, me propozim të këshilltarëve, Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **28.05.2025**, me 17 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI

1. Të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë familjes:
- **Znj.Manjola Nezir Mera** në vlerën **15.000** lekë.
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për familjen e përcaktuar në pikën 1, do të jetë deri në fund të muajit Janar 2026.
3. Për familjen, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, kryerja e pagesës do të kryhet pasi të dorëzohet numri i llogarisë së qiradhënësit pranë Drejtorisë Ekonomike, referuar kontratës të qerasë noteriale.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Ekonomike, Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit.
5. Vendimi u shpall me datë **28.05.2025**.

Zv/ Kryetar i Këshillit Bashkiak

Mario FEJZA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.437/1 prot.

Peshkopi, më 04.06.2025

Lënda: Për vendimin nr.19, datë 28.05.2025 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.19, datë 28.05.2025 “*Për trajtimin me subvencion të qerasë znj. Manjola Nezir Mera*”, konstatova se:

Akti administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi bën pjesë në kategorinë e akteve me karakter individual, për pasojë nuk është në kompetencë të Prefektit të shprehet për ligjshmërinë e kësaj vendimmarrje.

Hyrja në fuqi e akteve administrative të kësaj natyre, bëhet sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenin 55/6 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

PREFEKTI

Nexhmedin SHEHRI



RELACION
“PËR MIRATIMIN E VLERËS SË SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR ZNJ.
MANJOLA MERA”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar, vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të strehimit nga organet e Vetëqeverisjes vendore”, shpenzimet mesatare referuar shkresës së MBEK nr. 12856 Prot., datë 13/11/2024, adresuar Bashkisë Dibër, “Për vlerësimin e nivelit të të ardhurave mesatare të familjeve”, të dhëna që do të përdorën për vlerësimin e nivelit të të ardhurave të familjeve sipas nenit 2, pika 45 ligjit “Për strehimin social”. Znj. Manjola Mera ka paraqitur kërkesën me nr 1542 prot., datë 25/04/2025 ku kërkon nga Bashkia Dibër trajtimin e menjëhershëm me bonus qiraje. Pasi rasti është marrë në shqyrtim nga Sektori i Strehimit, Znj. Manjola Mera është asistuar nga punonjës të këtij sektori, që të paraqesë aplikimin nëpërmjet portalit e-albania dhe në plotësimin e të gjithë dokumentacionit përkatës. Pas shqyrtimit të dokumentacionit kjo familje sipas urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes i lëshuar me Vendimin nr.13, datë 23.03.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ndodhet në kushtet e situatës së dhunës në familje, e vërtetuar me urdhër mbrojtjeje apo urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje lëshuar nga gjykata ku referuar nenit 2, pika 45 të ligjit të strehimit social, *“Kushte emergjente për strehim” janë kushtet në të cilat ndodhen individët/familjet që banojnë në banesa në rrezik shembjeje, në banesa që nuk plotësojnë kushtet higjieno-sanitare, në banesa në proces legalizimi që pësojnë dëme për shkak të fatkeqësive natyrore, në banesa që prishen për shkak të ndërtimeve të veprave publike, të cilët nuk përfitojnë kompensim financiar nga procedurat e shpronësimit, dhe të ndërtimeve në proces legalizimi që nuk legalizohen, por trajtohen nga shteti nëpërmjet programeve të strehimit të përshtatshme, në përputhje me përcaktimet e legjislativës për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë dhe ato familje/individë, të cilët ndodhen në kushtet e situatës së dhunës në familje, e vërtetuar me urdhër mbrojtjeje apo urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje lëshuar nga gjykata.* Referuar kushteve emergjente për strehim, kushteve ekonomike dhe sociale në të cilat kjo familje ndodhet, bazuar kontratës noteriale të qirasë, me propozim të këshilltarëve në mbledhjen e datës _____.2025, kërkohej miratimi i subvencionimit të qirasë të kësaj familje sipas të dhënave mëposhtë:

Llogaritja e masës së subvencionimit të qirasë

№	Emri, Adresa, Mësimi	Kategoria dhe niveli i dëmtimit nga shprehja e dëmtimit	Indeksi	Indeksi	Indeksi	Indeksi	Indeksi	Indeksi	Indeksi	Indeksi	Indeksi	Indeksi
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l	m
1	Manjola Nezir Mera	Viktimat e dhunës në familje, Ndihmë Ekonomike	5	1-1	81	15.000	0	15	0	0	15.000	15.000

Sektori i Pronave dhe Strehimit


Përgjegjës

Gazmend Miftari



Specialist

Xhesika Rama



Specialist

Memor Bitri

